

LIGJ
Nr. 7/2012

PËR RATIFIKIMIN E VENDIMEVE TË KËSHILLIT ADMINISTRATIV DHE TË BORDIT DREJTUES TË BANKËS PËR ZHVILLIM TË KËSHILLIT TË EUROPËS (CEB), REZOLUTA NR.1532 “PROPOZIM I KËSHILLIT ADMINISTRATIV MBI RRITJEN E KAPITALIT TË BANKËS” (SHTOJCA A), REZOLUTA NR.386 “VENDIM MBI RRITJEN E KAPITALIT TË BANKËS” (SHTOJCA B), SI DHE DOKUMENTI “LETRA E GUVERNATORIT TË BANKËS, DATË 8.4.2011, MBI FAZAT E RRITJES SË KAPITALIT”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohen vendimet e Këshillit Administrativ dhe të Bordit Drejtues të Bankës për Zhvillim të Këshillit të Europës (CEB), rezoluta nr.1532 “Propozimi i Këshillit Administrativ mbi rritjen e kapitalit të Bankës” (shtojca A), dhe rezoluta nr.386 “Vendim mbi rritjen e kapitalit të Bankës” (shtojca B), si dhe dokumenti “Letra e Guvernatorit të Bankës, datë 8.4.2011, mbi fazat e rritjes së kapitalit”.

Neni 2

Rezolutat e mëvonshme, që nuk kanë të bëjnë me marrjen përsipër të detyrimeve financiare nga Republika e Shqipërisë, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 9.2.2012

Shpallur me dekretin nr.7287, datë 21.2.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi